



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Mjetet e dedikuara për financimin e edukimit parashkollor publik dhe mënyra e shpenzimit të tyre

NUMËR:2/2008

DATË:3.03.2008

Në bazë të nenit 1.3 pika d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr.1/2007, nenit 19 .6 të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1

Qëllimi

Me anë të këtij Udhëzimi administrativ rregullohet financimi, e drejta e institucioneve parashkollore në grumbullimin e të hyrave vetanake dhe administrative dhe mënyra e shpenzimit të tyre .

Neni 2

Marrja e vendimit

Vendimin për grumbullimin e mjeteve vetanake në përputhje me këtë Udhëzim administrativ e merr Këshilli i institucionit edukativo-arsimor.

Neni 3

Forma e grumbullimit të të hyrave

Institucioni mund të grumbullojë të hyra nga :

- a) pagesa nga participimi i prindërve që dedikohen për shërbime,
- b) donacion i prindërve (në emër të fondit të fëmijëve të institucionit),
- c) shitja e prodhimeve dhe e shërbimeve,
- d) donacione nga komuniteti,
- e) dhurata apo të mira tjera që i jepen institucionit.

Neni 4

Procedura e grumbullimit të të hyrave

1. Institucioni parashkollor është i obliguar që hyrjen e çdo mjeti vetanak ta bëjë transparent, duke respektuar procedurat e përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe akteve tjera ligjore që e rregullojnë këtë fushë.
2. Procedurat e grumbullimit të mjeteve vetanake përcaktohen nëpërmjet një marrëveshje të veçantë të institucionit parashkollor me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.
3. Me marrëveshje përcaktohen llojet mbi të hyrat vetanake, bartësi apo institucioni, numri i veçantë i llogarisë, mirëmbajtja e llogarisë, qarkullimi i mjeteve, destinacioni, mënyra e realizimit dhe barazimi i llogarisë.

Neni 5

Udhëheqja me mjete vetanake

1. Me mjete vetanake në një institucion udhëheq këshilli i institucionit .
2. Personi i autorizuar për administrimin e mjeteve vetanake është drejtori i institucionit, ndërsa aprovues është këshilli i institucionit .

Neni 6

Mënyra e destinimit të mjeteve vetanake

1. Mjetet nga participimi i prindërve kryesisht do të jenë për ushqim, material didaktik dhe material higjienik dhe për projekte të cilat e ngrisin cilësinë e mirëqenies së institucionit për pozicionin e shërbimeve dhe mallrave si dhe të shpenzimeve kapitale.
2. Çdo destinim tjetër që nuk është i paraparë me paragrafin 1 të këtij neni duhet të miratohet detyrimisht nga DKA-ja dhe MASHT-i.

Neni 7

Mirëmbajtja e dokumentacionit financiar

- 1.** Institucioni parashkollor është i obliguar që të mbajë dokumentacionin financiar mbi të hyrat vetanake si dhe mënyrën e shpenzimeve të tyre në përputhje me udhëzimet financiare në fuqi.
- 2.** Institucioni në përputhje me këtë udhëzim, bën planifikimin e shpenzimeve të institucionit dhe udhëheq të gjitha procedurat e prokurimit në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës.
- 3.** Drejtori është përgjegjës për udhëheqjen financiare të institucionit (zotuesi dhe miratuesi) dhe i raportojnë me shkrim këshillit të institucionit dhe DKA-së për gjendjen financiare të buxhetit së paku dy herë në vit e nëse ka nevojë edhe MASHT-it.

Neni 8

Auditimi

- 1.** Në raste të veçanta edhe njësi e Auditorit të Brendshëm pranë MASHT-it mund të ushtrojë kontroll financiar në cilindo institucion arsimor, duke mos përjashtuar as strukturat e ngjashme në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe Auditorin Gjeneral si institucion i pavarur i Kuvendit të Kosovës.
- 2.** Auditimi dhe inspektimi i institucionit bëhet nga MASHT-i.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ministri .

Enver Hoxhaj, ministër